

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rritje 3.61%, pagat dhe taksat shtyjnë ekonominë, prodhimi ngec
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/ekonomi/rritje-361-pagat-dhe-taksat-shtyjne-ekonomine-prodhimi-ngec-i1186085
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 13:32:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 13:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	52de835408a7b66ec4408c39b9e0411db06d83070bdd359a079c9d65b6f2c666
TEKSTI	13a203776db4571f1180461911fb40a60f163a03c774bd38476853b942d36f39
PAMJA	a1aa3ec1c4b74c9b5a19c4c6979d117d0c9e01936d7c6c598e54030a44fe3471

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0da96cf1c435d3de88ece21c74bcebab17b2ade7983778bc65f90b8a3176828c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5df8b09a82e67beafe6b324836ab8231b0f747e1cb5c8d4c8cb1ac702cd5a645
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0da96cf1c435d3de88ece21c74bcebab17b2ade7983778bc65f90b8a3176828c>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Rritje 3.61%, pagat dhe taksat shtynë ekonominë, prodhimi ngec

Nga Marjo Brakaj
29 Shtator 2026, 15:27 | Ekonomi



Ekonomia shqiptare u rrit me 3.61 për qind në tremujorin e dytë të vitit. Zgjerim i Prodhimit të Brendshëm Bruto në prill-qershor rezultoi në një ngadalësim me 0.1 pikë përqindje në raport me të njëjtën periudhë kohore të një viti më parë.

“Është një ekonomi që po rritet, por nuk po transformohet thellësisht dhe ky cikël rritje është i destinuar të ngadalësohet, nëse nuk ndryshon modeli ekonomik. Modeli aktual favorizon rritje të bazuar në konsum dhe investime jo gjithmonë produktive, në vend të një rritjeje të bazuar në inovacion, eksporte dhe kapital njerëzor. Ky model e mban ekonominë tonë me një rritje modeste, por nuk po ndryshon dot mënyrën se si ajo të krijojë mirëqenie. Po krijohen vende pune dhe po rriten pagat në disa sektorë, por vendi po prodhon më pak”, thotë për A2 CNN Eduart Gjokutaj, ekspert për ekonominë.

Kontributin kryesor në këtë ecuri e dha rritja e pagave në administratën publike, ndjekur nga taksat dhe turizmi me shitblerjen e pronave. E kundërta ndodhi me sektorët e punësimit masiv si bujqësia dhe industria. E para u tkurr me 0.38 për qind, ndërsa e dyta mbeti në vendnumëro.

“Kjo do të thotë, se në mungesë të reformave strukturore, si diversifikimi industrial, rritja e produktivitetit, menaxhimi më efikas i burimeve natyrore, reduktimi i informalitetit dhe investimet në aftësi e kapital njerëzor ekonomia shqiptare mund të mbetet e bllokuar në kurthin e të ardhurave të mesme. Kjo do të thotë se ritmi i rritjes do të jetë i pamjaftueshëm për të frenuar emigracionin, për të krijuar vende pune me vlerë të shtuar dhe për të përballuar nevojat në rritje për financimin e shërbimeve sociale, shëndetësisë dhe pensione”, thotë Gjokutaj.

Sipas metodologjisë tjetër të Institutit të Statistikave, asaj të shpenzimeve, në rritjen ekonomike në tremujorin e dytë të vitit kontributin kryesor e dhanë konsumi i popullatës dhe eksportet. E kundërta ndodh me konsumin e administratës, pavarësisht rritjes së pagave.

“Kjo strukturë tregon një ekonomi që konsumon më shumë se sa prodhon për eksport, me një bilanc negativ që vazhdon të financojë rritjen përmes remitançave, turizmit dhe FDI-ve. Por mosmarrja e veprimeve për një kthesë drejt përpunimit dhe eksporteve me vlerë të lartë, do të thellojë më tej deficitin tregtar dhe kjo do të shtojë presionin fiskal edhe mbi rezervat e valutës, që kanë shënuar rritje deri më sot”, thotë Gjokutaj.

Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë presin që ekonomia e vendit të rritet mesatarisht me 4 për qind këtë vit. Disi më pesimiste janë institucionet Ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe ajo Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim që presin zgjerim të Prodhimit të Brendshëm Bruto në mesatarisht 3.5 për qind.

(A2 Televizion)

TE FUNDIT

A u përballën Rama dhe Berisha? Balla takon gjermanët, përgjigjet për Hysenin, Agasin dhe Ballukun

Brukseli jep afate për anëtarësimin, Von Der Leyen të mërkurën në Tiranë, takon Ramën dhe Begajn

Vlora Hyseni nis betejën me drejtësinë, apelon masën e sigurisë, kërkon lirin nga arresti shtëpiak

Vlorë, e moshuara dhunohet dhe i grabitet banesa

MË TË VIZITUARAT

“Nuk ka kohë për qetësi”, Rutte: Kemi një mesazh të fortë për Moskën

Për herë të parë në 200 vjet, një grua do të ekzekutohet në SHBA

Rusia fillon mobilizimin, Zelenskyy: Koreja e Veriut do dërgojë 10 mijë trup...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Rinasit i vjen treni, shpallet fituesi për ndërtimin e stacionit



Ekonomia shqiptare rritet me 3.61% në tremujorin e dytë



Nga taksat te pagat. Paketa fiskale 2027 në tavolinë, biznesi hap listën e kërkesave



Japonia si model, Shqipëria në kërkim të motorit të ri ekonomik




"Future 2 Tech", panairi më i madh për teknologjinë në Shqipëri ka hapur dyert



Shqipëria rritet, por ngadalë. BERZH parashikon PBB 3.5% edhe për vitin e ardhshëm

Latest Videos





Dhunohet dhe grabitet 70-vjeçarja, Edi Ruçi: 43-vjeçari e goditi me sëpatë në kokë të moshuarën...



Çfarë sjell vala e re e Digjitalizmit? Nga identiteti digjital në 2027 të "E-KUPONËT"



Tjetër "goditje" për Veliajn nga SPAK. Nesër Brukseli "zbret" në Tiranë-PULS nga Bruna Çifligu



Rama: Cilësia e diellit në Shqipëri më e lartë se ajo e Brukselit

Shqipëria Aktualitet Kronikë Politikë Ekonomi Sociale Kulturë Moti	Kosova Kulturë Sociale Ekonomi Politikë Kronikë Aktualitet	Rajoni & Bota Ballkani Bota	Argëtim Showbiz Lifestyle Kapur në kamera Teknologji	Sport Live Euro 2024 Futboll Sporte të tjera	Speciale A2 5 gjëra në 5 minuta A2 CNN në Izrael 31 Minuta A2 CNN në Ukrainë Lumi i kokainës Ditari ndërkombëtar Zbulo Imagjinatë Dëshmi	f t i y
--	---	--	---	--	--	---

[Rreth nesh](#) [Kushtet e Privatësisë](#) [Karriera](#) [Kontakt](#)

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
 All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.